

BASHKËPUNËTORI I DREJTËSISË

Personi që ka marrë pjesë në kryerjen e një veprimi korruptiv me një gjyqtar/prokuror ka të drejtë t'i drejtohet zyrës së prokurorisë kompetente për të dhënë informacion të mjaftueshëm për këtë veprim. Në këtë rast, atij mund t'i jepet **statusi i bashkëpunëtorit të drejtësisë** dhe të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi.

- Bashkëpunëtori i drejtësisë **duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht**, për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat që shërbejnë si prova vendimtare për zbulimin, hetimin dhe parandalimin e korrupsionit të gjyqtarëve/prokurorëve.
- Bashkëpunëtori i drejtësisë **nuk mund të ndiqet penalisht** për veprat e korrupsionit që ka kryer me gjyqtarin/prokurorin, sipas dëshmisë së dhënë.
- Gjyqtari/prokurori që ka përfituar shumë, **mbart detyrimin t'ia kthejë atë bashkëpunëtorit të drejtësisë**.
- Një kopje e dëshmisë dhe e marrëveshjes së bashkëpunimit i jepet bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe institucioneve të rivlerësimit.

Qendra Europiane dhe Qendra ALTRI prezantojnë me kënaqësi punën e tyre në kuadër të projektit "Për një gjyqësor të pavarur dhe profesional: bashkëpunohet edhe ti!", të zbatuar si pjesë e planit të veprimit të Koalicionit "Drejtësi për të gjithë".

JU MIRËPRESIM NË FORUMET DHE DISKUTIMET TONA



QENDRA EUROPIANE
QENDRA ALTRI
KOALICIONI "DREJTËSI
PËR TË GJITHË"

#bashkepunoedheti

www.euro-centre.eu
info@euro-centre.eu

www.altri.al
gendra.altri@gmail.com



BASHKËPUNO EDHE TI!

ROLI I QYTETARËVE NË PROCESIN E VETINGUT



ÇFARË ËSHTË VETINGU?

Vetingu është rivlerësimi kalimtar i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të vendit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

PROCESI I RIVLERËSIMIT

Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kriterëve:

- A. VLERËSIMI I PASURISË;
- B. KONTROLLI I FIGURËS; DHE
- C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Institucionet e rivlerësimit janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe komisionerët publikë. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

QYTETARË! NJË KONTRIBUT SHUMË TË RËNDËSISHËM NË KËTË PROCES MUND TË JEPNI EDHË JU!

SI MUND TË KONTRIBUOJNË QYTETARËT NË KËTË PROCES?

Ligji 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i njohur si ligji për vetingun, parashikon:

- ✓ Në nenin 53 të tij **pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e fakteve ose rrethanave** që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit;
- ✓ Në nenin 54 të tij **bashkëpunimin e qytetarëve me prokurorinë në denoncimin e rasteve të korrupsionit** të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË DENONCIMIN E FAKTEVE OSE RRETHANAVE

Çdo person që ka ose vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit.

Informacioni i ofruar nga qytetarët duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjor të gjyqtarit/prokurorit, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit.

Informacioni i ofruar nga qytetarët duhet të përqëndrohet në shkelje ligjore që lidhen me:

- ✓ Pasurinë e gjyqtarit/prokurorit dhe të personave të lidhur me ata;
- ✓ Kontakte të gjyqtarit dhe prokurorit me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ✓ Etikën dhe aftësinë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;

Me qëllim lehtësimin e paraqitjes së informacionit nga publiku, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelit publikojnë një **model denoncimi**.

Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme. Ata gëzojnë të drejtën e **konfidencialitetit dhe mbrojtjes kundër hakmarrjes**.